



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrin 63.1 nënparagrin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrin 1 nënparagrin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Bereqeti-ing" të datës 22.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-22-11826-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 178 521, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHEȚ** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Bereqeti-ing" e datës 22.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-22-11826-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 178 521.
- II. **AUTORIZOHEȚ** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEȚ** operatori ekonomik "Bereqeti-ing" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Bereqeti-ing" (tutje "parashtruesi) me datë 22.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 19.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-22-11826-5-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 178 521.

Faqe 1 nga 3

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtuesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtuesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtuesit janë cituar si në vijim: “*Duke marr parasysh vrejtet e derguara ne afat kohor ne emailat dhe duke par gabimet e bera kemi kerkuar qe shqyrtohet dhe vlersohet ne menyr te drejt. A.K. nuk eshte sjellë korekt dhe e barabart qe ne fillim ku ka kushtuar me marun projektin ne cd e qe eshte nje faqe a4 si dhe pershkrimi teknik ne paramas dhe paralogari eshte caktuar dhe jemi kushtuar qe te sjellim mostren para dorzimit ku mostrat e konkurentve qalojn nga kerkesat e A.K. e qe AK ne menyr te nje anshme ka desht me bere anulimin e pa bazuar qe nuk ka quar peshe financiare, matriale dhe punuse ne grahasim me projektin. Pavarisht emailave dhe shkresave nga ana e jone A.K. ka vepruar ne kundershtim me ligjin konkretisht nenet e cekura me siper. Deshmi do ti sjellim ne vazhdim si emaila dhe foto ku shihen qart ndryshimet e mostrave te konkurentve tjer ku ne i kemi punuar sipas specifikave tekniqe dhe paramases”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtuesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 28, 52, 59 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 25.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtuesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parashtuesit fillimisht duhet cekur se parashtuesi nuk ka arritur të shpjegoj se cili veprim i autoritetit kontraktues është në kundërshtim me cilën dispozitë ligjore në fuqi dhe mbi bazën e cilave dëshmive, argumente apo fakte është i bazuar ky pretendim. Formulimi i parashtuesit përmes shprehjeve si “*duke par gabimet e bera kemi kerkuar qe shqyrtohet dhe vlersohet ne menyr te drejt. A.K. nuk eshte sjellë korekt dhe e barabart qe ne fillim ku ka kushtuar me marun projektin ne cd e qe eshte nje faqe a4 si dhe pershkrimi teknik ne paramas dhe paralogari eshte caktuar dhe jemi kushtuar qe te sjellim mostren para dorzimit ku mostrat e konkurentve qalojn nga kerkesat e A.K. e qe AK ne menyr te nje anshme ka desht me bere anulimin e pa bazuar qe nuk ka quar peshe financiare, matriale dhe punuse ne grahasim me projektin*” nuk evidenton asnjë rrethanë faktike apo juridike sipas të cilës do të mund të konstatohej nëse AK ka vepruar në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore të legjislacionit primar ose sekondar në fuqi për prokurimin publik. Pjesa ku thuhet se AK “*ka kushtuar me marun projektin ne cd e qe eshte nje faqe a4*” nuk manifeston asnjë manifestim logjik apo ligjor pasi që dorëzimi i një CD lidhur me një dokument që mund të ketë një (1) faqe A4 nuk përbën asnjë shkelje ligjore (të paktën jo për aq sa parashtuesi e ka përshkruar këtë pjesë të pretendimit të tij). Ngjashëm edhe pjesa e pretendimit ku thuhet “*jemi kushtuar qe te sjellim mostren para dorzimit ku mostrat e konkurentve qalojn nga kerkesat e A.K.*” sërisht nuk arrin të shpërfaq ndonjë shkelje ligjore për shkak të mungesës së ndërlidhjes logjike, ligjore dhe kauzale pasi që kushtëzimi i mostrave në njëren anë dhe “*qalimi*” i përbushjes së këtij kushti nga një ose disa prej tenderuesve nuk përbën shkelje ligjore të paktën jo për aq sa parashtuesi e ka përshkruar këtë pjesë të pretendimit të tij).

#### Faqe 2 nga 3

Sa i përket pjesës ku parashtruesi pretendon se do të dërgoj disa fotografi dhe emaila si dëshmi për pretendimet e parashtruara, duhet theksuar se në autoritetin kontraktues nuk është pranuar asnjë dëshmi nga parashtruesi lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim.


Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.05.2023



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtaues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinës 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)